



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

19.04.2022, Prishtinë

Thirrje për aplikim

Bazuar në Thirrjen publike për projekt-propozimet kulturore 2022 art dhe trashëgimi kulturore, të datës 01.04.2022 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në përputhje me Nenin 8, paragrafin 3.2 të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, ftojme organizatat jo qeveritare/shoqërinë civile/njohësit e kulturës, të aplikojnë për të marr pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë:

- përfaqësues nga OJQ-të

- përfaqësues në cilësinë e njohësit të kulturës dhe trashëgimisë kulturore

Të drejtë aplikimi kanë:

1. Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
2. Njohësit e kulturës.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një CV;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Përfaqësuesi nga OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo i angazhuar në organizatë.

Përfaqësuesit e lartpërmendur do të jenë anëtarë të Komisionit vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve për projekte art dhe trashëgimi të pranuar nga organizatat jo qeveritare (OJQ) sipas thirrjes publike të datës: 01.04.2022.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: tylaj.shilek@rks-gov.net, zana.llonqari@rks-gov.net dhe dafina.rexhepi@rks-gov.net deri me datën 27.04.2022, dhe të shkruhet në **subjekt pozitën për anëtar të komisionit për të cilin aplikoni.**

MKRS-ja do të vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe do të përzgjedhë kandidatët, të cilët do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike të datës 01.04.2022 të publikuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.